

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. J. nga fshati P., KK. P., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 285 par.2 të KPK-së, si dhe për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 285 par. 2 dhe par.1 të KPK-së, sipas Aktakuzave me numra: PP.nr.1878-14/2011 e dt.28.04.2011, PP.nr. 3894-13/2011 e dt.18.08.2011, P.nr.4976/2012 e dt.11.09.2012 PP.nr.4945/12 e dt.18.09.2012, PP.nr.3250/12 e dt.17.08.2012, PP.nr.4056/2012 e dt.28.02.2012, të PPK në Prishtinë, tani Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më datë 16.05.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ajshe Ferati dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 23.05.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit,

SH. J., nga i ati S. dhe nënës H., e vajzërisë F., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin B., KK. P., tani me vendbanim në fshatin P., Komuna e P., me numër personal: *numër personal*, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion bujk, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka qenë i gjykuar edhe më parë për veprë të njëjtë penale, ndaj zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 nënpar. 1.1 të KPPRK-së,

REFUZOHET AKTAKUZA

S e p s e:

Me datën 23.06.2012, rreth orës 08:20, në pyllin publik të quajtur "Rrahu" në Regjionin ekonomik-pyJOR Turuqicë KK Podujevë, me të cilin menaxhon Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit `i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë 31 copë trungje të llojit ahu, me sharrë motorike dhe traktor IMT 539, me dimensione 14metra, diametër 28-32cm, me vëllim të përngjitshim 8.95m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 285 par.2 të KPK-së.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I. Ndërsa i njëjti i akuzuar me shënime si më lart,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Më dt.17.02.2011,rreth orës 09:30, me qëllim vjedhje, në vendin e quajtur “Kodra e Stanicës” në Regjionin Ekonomiko-Pyjor, Tërnavë KK Podujevë, i pandehuri Sh.J., është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë me sharrë 62 copë dru të llojit bungu-çarr,9m të gjata , me diametër 18-20cm, me vëllim të përgjithshëm, 5.58m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor të Kosovës-zyra në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Më datë 23.03.2011, rreth orës 06:00, me qëllim vjedhje, në vendin e quajtur “Kodra e Stanicës” në Regjionin Ekonomiko-Pyjor, Tërnavë KK Podujevë, i pandehuri Sh. J., është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë me sharrë motorike 97 copë dru të llojit bungu-çami 9 m të gjata , me diametër 15.18cm, me vëllim të përgjithshëm, 5.35m³, me ç` rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor të Kosovës-zyra në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 18.05.2011,rreth orës 15:00, në pyllin e Autoritetit Pyjor të Kosovës zyra në Podujevë’, në vendin e quajtur”Përoi i Pajtimit” Regjioni Ekonomiko-Pyjor i Tërnavicës ,Komuna e Podujevës, me qëllim të vjedhjes ka prerë 28 copë trungje të llojit ahu dhe shkoze me gjatësi 14m, me diametër 10-18cm,dhe me vëllim të përgjithshëm 5,70m³, me ç` rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor –zyra në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 02.06 2011,rreth orës 08:15, në pyllin e Autoritetit Pyjor të Kosovës zyra në Podujevë’, në vendin e quajtur ”Përroi i Pajtimit” Regjioni Ekonomiko-Pyjor i Tërnavicës ,Komuna e Podujevës, me qëllim të vjedhjes ka prerë 27 copë trungje të llojit ahu dhe shkoze me gjatësi 14m, me diametër 19-27cm,dhe me vëllim të përgjithshëm 5,05m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor –zyra në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 01.05.2012, rreth orës 08:00, në pyllin publik të quajtur “Rrahu” në Regjionin ekonomiko-pyjor Turuqicë, me të cilin menaxhon Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t`i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja e pyllit duke prerë me sharrë motorike 21 copë trungje të llojit ahu dhe bartë me traktor Rakovicë, me dimensione 12-15 metra të gjata, diametër 28-32cm, me vëllim të përgjithshëm 6.44m³, me ç` rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 29.05.2012, rreth orës 08:00, me qëllim për të vjedhur ka shkuar në pyll në vendin e quajtur Rrahu, në Regjionin Ekonomiko Pyjor- Turuqicë, Komuna Podujevë, me të cilin qeverisë Agjencioni Pyjor i Kosovës zyra në Prishtinë , ku aty ka prerë 29 copë trungje të llojit ahu, me diametër 28-32cm, me gjatësi prej 14m, me vëllim të përgjithshëm 8,25m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës-zyra në Prishtinë i ka shkaktuar dëm material.

Me datë 23.06.2012, rreth orës 08:20, me qëllim vjedhje, në pyllin me të cilin qeverisë Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, KK Podujevë, në vendin e quajtur "Rrahu" Regjioni Ekonomiko-Pyjor i "Turuqicës" KK Podujevë, më sharrë motorike, ka prerë dhe marrë 31 copë dru ahu me gjatësi 14m, me diametër 28-32cm, me vëllim të përgjithshëm 7.62m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural KK Podujevë i është shkaktuar dëm material.

Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 285 par.2 dhe par.1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 3,6,11,15,23,34,41,42,43,44,64, dhe 285 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 450, 453, 463, të KPPPK-së, e

G J Y K O N

Të akuzuarin Sh.(S.) J., me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej një 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushalle të paguaj shumën prej **50€ (pesëdhjetë/euro)**, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - KK. Podujevë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzat: PP.nr.1878-14/2011 e dt.28.04.2011, PP.nr. 3894-13/2011 e dt.18.08.2011, P.nr.4976/2012 e dt.11.09.2012 PP.nr.4945/12 e dt.18.09.2012, PP. nr.3250/12 e dt.17.08.2012, PP.nr.4056/2012 e dt.28.02.2012, kundër të akuzuarit Sh. J. nga fshati P., KK. P., për shkak të veprave penale Vjedhje pyllit nga neni 285 par.2 dhe 1 të KPK-së.

Lidhur me këto çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 16.05.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ajshe Ferati dhe të akuzuarit Sh. J., në të cilën fillimisht pas verifikimit të kaluarës kriminale për të akuzuarin, si dhe me pajtimin e palëve respektivisht prokurorit të shtetit dhe të akuzuarit, bazuar në nenin 35 par.8 të KPPRK-së, si dhe duke pasur parasysh parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetin të procedurës penale, mori aktvendim që të bashkohet procedura penale dhe të zbatohet procedurë unike kundër të akuzuarit Sh. J. për lëndët penale Pka.nr.71/11, Pka.nr.114/11, Pka.nr.310/12, P.nr.1256/12, P.nr.1465/12, P.nr.1466/12, tani e tutje procedura penale për këto lëndë do të mbaj numrin më të vjetër **P.ka.nr.71/11**.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar gjatë leximit të aktakuzave konstatoi se aktakuza me nr. PP. nr.4976/12 e dt.11.09.2012 që mbanë numrin e lëndës në gjykatë P.nr.1465/12 dhe aktakuza me nr. PP.nr.4945/12 e dt.18.09.2012 që mbanë numrin e lëndës së gjykatës P.ka.nr.310/12, në përshkrimin e dispozitivit të dy aktakuzat kanë datë të njëjtë,

kohë të njëjtë dhe vend të njëjtë, si dhe personi i njëjtë që ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit, nuk qëndron fakti se i njëjti ka mundur t'i kryej këto dy vepra penale në të njëjtën kohë dhe vend, andaj heqë dorë konform nenit 52 të KPRK-së, sa i përket aktakuzës me nr. PP. nr.4976/12 e dt.11.09.2012 që mbanë numrin e lëndës së gjykatës P.nr.1465/12. Ndërsa lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që është bërë konform dispozitat e KPRK-së dhe është në përputhshmëri me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nga të cilat janë ngritur aktakuzat.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se në tërësi e pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzave dhe ka shtuar se arsyeja pse kam prerë dru ka qenë për shkak se i kemi dy motra të sëmura dhe një vëlla të verbër dhe me të hollat që i kemi siguruar nga shitja e drunjve i kemi dërguar në shërim në Shkup e po ashtu prindin –babain e kemi pasur të sëmur nga zemra i cili ka vdekur para një muaji, jemi në një gjendje të rëndë ekonomike, të pa punë, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe kërkoj nga gjykata që mundësisht të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, ka konstatuar se i akuzuari në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 285 par.2 dhe par.1 të KPK-së, pasi që janë kryer disa vepra penale, janë të llojit të njëjtë, i ka kryer i njëjti person të gjitha veprat penale, të gjitha veprat penale janë kryer brenda periudhës së shkurtë kohore, të gjitha këto vepra penale janë kryer me dashje nga kryerësi dhe janë kryer kundër të dëmtuarës së njëjtë.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit Sh. J. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në vazhdimësi vjedhja e pyllit nga neni 285 par.2 dhe par. 1 të KPK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpall fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket pikës I. të dispozitivit meqenëse Prokurori i Shtetit hoqi dorë nga ndjekja penale, Gjykata mori aktgjykim refuzues me të cilin refuzohet aktakuza për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 64 të KPK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe se ishte korrekt gjatë shqyrtimit fillestar, rrethanat personale-familjare, pasi që i njëjti ka tre familjarë (dy motra dhe një vëlla me të aftësi të kufizuara), i gjendjes së rëndë ekonomike-sociale, të gjitha veprat penale janë kryer në vitin 2011-2012, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë për vepra të njëjta penale, prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-paushallit gjyqësor, sa i përket pikës I. të dispozitivit u morë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së, ndërsa sa i përket pikës II. të dispozitivit u morë në bazë të nenit 450 par.1 dhe par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimit të kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marr në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që gjykata nuk pati ekspertizë nga ndonjë institucion i pavarur, në mënyrë që gjykata të vërtetoj saktësisht dëmin e shkaktuar, ashtu që dëmi i vlerësuar vetëm nga pala e dëmtuar nuk paraqet bazë të sigurt për gjykim, andaj gjykata nuk e pranoi dhe mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 363 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
PKa.nr.71/2011,dt.23.05.2016

Sekretarja juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.